



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare

Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačke Borbe

Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPFVLÇ) NR. 01/2026 PËR PROCEDURËN E DHËNIES, PËRSËRITJES, PEZULLIMIT DHE MARRJES SË LICENCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE¹

¹ Udhëzim Administrativ (MPFVLÇ) Nr. 01/2026 për Procedurën për Dhënie, Përsëritje, Pezullimin dhe Marrjen e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, miratuar nga Ministri me Vendimin Nr. 01/2026, të datës 08.07.2026

Ministri i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare,

Në mbështetje të nenit 68 paragrafi 1, nenit 69 paragrafi 9 dhe nenit 79 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në përputhje me nenin 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPFVLÇ) NR. 01/2026
PËR PROCEDURËN E DHËNIES, PËRSËRITJES, PEZULLIMIT DHE MARRJES SË
LICENCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktohen procedurat e aplikimit, kushtet për dhënien, përsëritjen, pezullimin dhe marrjen e licencës, procedurat e shqyrtimit dhe vendosjes për licencim, llojet e shërbimeve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe shpenzimet për licencim për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, përfshirë institucionet publike, organizatat joqeveritare dhe personat fizikë e juridikë që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

**Neni 3
Përkufizime**

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, kanë të njëjtin kuptim me shprehjet në Ligjin nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare.

**Neni 4
Kushtet për dhënien e licencës**

1. Ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare duhet të plotësojë kushtet në vijim:

1.1. të jetë i regjistruar në pajtim me ligjin;

1.2. të plotësojë kushtet e përcaktuara për hapësirën, infrastrukturën, pajisjet dhe kuadrin profesional të licencuar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, në pajtim me aktin përkatës nënligjor për kushtet dhe themelimin e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare;

1.3. të plotësojë standardet minimale të përcaktuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, për të cilin kërkon pajisjen me licencë.

Neni 5

Aplikimi për licencim

1. Ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare parashton kërkesën për licencim në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (në tekstin e mëtejme: Ministria).

2. Kërkesës për licencim, i bashkëngjiten dokumentet, si në vijim:

2.1. Akti i themelimit të institucionit publik;

2.2. Certifikata e regjistrimit për organizatat joqeveritare, personat fizikë dhe juridikë;

2.3. Statuti me të cilin dëshmohet ushtrimi i aktivitetit në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, për të cilin aplikohet për licencim;

2.4. Plani i ofrimit të shërbimeve, shërbimet dhe numri i përfitueseve;

2.5. Certifikatë pronësie, kontratë qiraje apo dokument tjetër të organit kompetent, si dëshmi për hapësirën e mjaftueshme;

2.6. Dëshmi që i plotëson kushtet e parapara në pikëpamje të hapësirës, infrastrukturës dhe kuadrit profesional;

2.7. Dëshmi për listën e pajisjeve adekuate që ka në pronësi ose në posedim për ofrimin e shërbimeve;

2.8. Kopje të licencave të ofruesve individualë, varësisht nga lloji i shërbimit që aplikon për licencim, së bashku me kontratën e punës apo dëshminë me të cilën konfirmon marrëveshjen për ofrimin e shërbimit;

2.9. Certifikatë nga Gjykata kompetente që subjekti juridik nuk është në proces të falimentimit;

2.10. Certifikatë për evidencën penale për personat përgjegjës të subjektit juridik;

2.11. Dëshmi lidhur me detyrimet tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejme ATK).

3. Në momentin e krijimit të modulit për aplikim elektronik, të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin kërkesat e tyre në formë elektronike.

Neni 6

Llojet e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, aplikojnë për licencim në përputhje me statutin e tyre dhe zgjedhin llojin e shërbimit për të cilin aplikojnë, sipas Listës së shërbimeve sociale dhe familjare e cila është pjesë e këtij Udhëzimi Administrativ.
2. Lista me llojet e shërbimeve sociale dhe familjare, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë.

Neni 7

Obligimi për njoftim

1. Ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare e njoftojnë zyrtarisht Ministrinë, për çdo ndryshim lidhur me kushtet dhe dokumentacionin me rastin e licencimit.
2. Në varësi të ndryshimeve të bëra, vendoset në mënyrë meritore lidhur me njoftimin e pranuar.
3. Për ndryshimet që ndikojnë në plotësimin e kushteve të përcaktuara për licencim, duhet miratim përkatës nga Ministria.

Neni 8

Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim të Kërkesave për Licencim

1. Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim të Kërkesave për Licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, emërohet me vendim të Ministrit dhe përbëhet nga pesë (5) anëtarë, si në vijim:
 - 1.1. Dy (2) përfaqësues nga Departamenti përkatës për Shërbime Sociale dhe Familjare;
 - 1.2. Një (1) jurist nga Ministria;
 - 1.3. Një (1) përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale;
 - 1.4. Një ekspert me së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, i cili nuk përfaqëson ndonjë organizatë që aplikon për licencim, i përzgjedhur përmes procesit të shpalljes publike.
2. Anëtarët nga nënparagrafi 1.1 i paragrafit 1, duhet të kenë tre (3) vite përvojë pune në administratën publike dhe përgatitje në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

3. Anëtari nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1, duhet të ketë tre (3) vite përvojë pune në Qendrën për Punë Sociale dhe të jetë i licencuar në nivelin profesional për shërbime sociale dhe familjare.

4. Mandati i anëtarëve nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) vite me mundësi riemërimi edhe për një mandat.

Neni 9

Shqyrtimi i kërkesës për licencim

1. Kërkesa për licencim shqyrtohet nga Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim të Kërkesave për Licencim, brenda afatit prej dyzetepesë (45) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për licencim.

2. Kërkesat për licencim, kompletohen dhe përgatiten për shqyrtim dhe vendosje në kuadër të Departamentit për Shërbime Sociale dhe Familjare (në tekstin e mëtejme: Departamenti), i cili shërben si Sekretariat i Komisionit.

3. Komisioni mund të mbajë takim për shqyrtim dhe vlerësim, kur janë prezent 2/3 e anëtarëve.

4. Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim, vlerëson dhe analizon dokumentacionin e dorëzuar dhe realizon vizitë në terren për verifikimin e gjendjes faktike, lidhur me plotësimin e kushteve të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ nga ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare.

5. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, mund të bëhet verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar si dhe të kërkojnë informata zyrtare nga institucionet kompetente.

6. Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim përcakton listën e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare që kanë plotësuar kushtet për licencim dhe ia dorëzon Ministrit për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (në tekstin e mëtejme: Ministri).

7. Sipas rekomandimit nga Komisioni, Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (në tekstin e mëtejme: Ministri), në pajtim me kompetencat ligjore, brenda afatit prej dyzetepesë (45) ditësh, nxjerr vendim dhe lëshon licencën për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare. Vendimi i Ministrit për licencim është përfundimtar.

Neni 10

Vlefshmëria e licencës

1. Vlefshmëria e licencës së lëshuar për herë të parë është në kohëzgjatje tre (3) vjeçare, rilicencimi ka vlefshmëri pesë (5) vjeçare.

2. Licencat e lëshuara për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, evidentohen në Regjistrin Qendror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave.

3. Licenca lëshohet në pajtim me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 11

Procedura për përsëritjen e licencës

1. Për përsëritjen e licencës vlejné kushtet të cilat aplikohen në kohën e paraqitjes së kërkesës për licencim.

2. Ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare duhet të paraqesë kërkesë për përsëritjen e licencës, më së voni tre (3) muaj para skadimit të afatit për të cilën është dhënë licenca.

3. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, me rastin e paraqitjes së kërkesës për përsëritjen e licencës, ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare duhet të bashkëngjisë dokumentet në vijim:

3.1. Aktin e themelimit të institucionit publik;

3.2. Certifikatën e regjistrimit për organizatat joqeveritare, personat fizikë dhe juridikë;

3.3. Statutin me të cilin dëshmohet ushtrimi i aktivitetit në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, për të cilin aplikohet për licencim;

3.4. Certifikatën e pronësisë, kontratën e qirasë apo dokument tjetër të organit kompetent, si dëshmi për hapësirën e mjaftueshme;

3.5. Dëshminë që i plotëson kushtet e parapara në pikëpamje të hapësirës dhe infrastrukturës;

3.6. Dëshminë për listën e pajisjeve adekuate që ka në pronësi ose posedim për ofrimin e shërbimeve;

3.7. Kopjen e licencave të ofruesve individualë, varësisht nga lloji i shërbimit që aplikon për licencim, së bashku me kontratën e punës apo dëshminë me të cilën konfirmon marrëveshjen për ofrimin e shërbimit;

3.8. Certifikatën nga gjykata kompetente që subjekti juridik nuk është në proces të falimentimit;

3.9. Certifikatën për evidencën penale për personat përgjegjës të subjektit juridik;

3.10. Dëshminë lidhur me detyrimet tatimore ndaj ATK-së;

3.11. Dëshminë e pasqyrës financiare për të hyrat në vitin e fundit fiskal;

3.12. Raportin për zbatimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, për periudhën e kohëzgjatjes së licencës paraprake.

4. Në procedurën e rilicencimit zbatohet përshtatshmërisht proceduara dhe afatet e përcaktuara për procedurën e licencimit.

5. Nëse ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare nuk e ka zhvilluar asnjë aktivitet përgjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës, organi kompetent kërkesën për ripërsëritje do ta shqyrtojë si kërkesë për licencim, në pajtim me këtë Udhëzim Administrativ.

6. Nëse ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare, kërkesën për rilicencim nuk e paraqet brenda afateve ligjore të përcaktuara, kërkesa për rilicencim do të refuzohet për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor.

Neni 12

Përmbajtja e licencës

1. Certifikata e licencës për ofruesin e shërbimeve sociale dhe familjare, përmban:

- 1.1. stemën e Republikës së Kosovës;
- 1.2. institucionin që e lëshon licencën;
- 1.3. numrin e certifikatës së licencës;
- 1.4. llojin e shërbimit të licencuar;
- 1.5. emërtimin e institucionit, përkatësisht ofruesit të shërbimit të licencuar;
- 1.6. adresën e institucionit, përkatësisht ofruesit të shërbimit të licencuar;
- 1.7. numrin e regjistrimit të institucionit, përkatësisht ofruesit të shërbimit të licencuar;
- 1.8. datën e lëshimit dhe afatin e vlefshmërisë së licencës;
- 1.9. datën dhe nënshkrimin nga Ministri;
- 1.10. vulën e Ministrisë.

Neni 13

Shpenzimet

Shuma e tarifës që do të paguajë ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare për paraqitjen e kërkesës për licencim, do të caktohet me vendim nga Ministri duke marrë parasysh vlerësimin paraprak të kostos buxhetore.

Neni 14

Pezullimi i licencës

1. Nëse organi kompetent, përkatësisht, Njësia përkatëse e Inspektimit në Ministri, gjatë periudhës për të cilën është dhënë licenca, konstaton se institucioni apo ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare tanimë nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, do të zhvillojë procedurën për pezullimin e licencës.
2. Me vendimin për pezullim të licencës, konstatohen mangësitë e evidentuara dhe përcaktohet afati për evitimin e tyre.
3. Institucioni dhe ofruesi i shërbimit social dhe familjar, nuk mund të vazhdojë të ofrojë shërbime gjatë kohës për të cilën i është pezulluar licenca, deri në skadimin e afatit për eliminimin e mangësive.
4. Pezullimi bëhet për një periudhë të caktuar nga organi kompetent, varësisht nga mangësitë e evidentuara, gjatë së cilës ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare duhet të eliminojë mangësitë e konstatuara.
5. Nëse ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare nuk i eviton brenda afatit mangësitë e konstatuara, Njësia e Inspektimit rekomandon marrjen e licencës për shërbime sociale dhe familjare.

Neni 15

Marrja e Licencës

Ministri, sipas rekomandimit nga Njësia e Inspektimit, merr vendim për marrjen e licencës së institucionit apo ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare, nëse në afatin e përcaktuar nga Njësia e Inspektimit në Ministri nuk i ka eliminuar mangësitë e konstatuara.

Neni 16

Parandalimi i konfliktit të interesit

Në pajtim me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, të gjithë zyrtarët e përfshirë në procesin e licencimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, janë të obliguar që të veprojnë në pajtim me detyrimet ligjore për parandalimin dhe evitimin e konfliktit të interesit.

Neni 17
Regjistri i të dhënave

1. Ministria mban regjistrin e të dhënave në kopje fizike dhe elektronike, ku përfshihen informatat për ofruesit e shërbimit që aplikojnë për të fituar licencën për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, profesionistët e licencuar në kuadër të ofruesit të shërbimit, licencat e lëshuara, vendimet për licencim, institucionet kompetente për zbatimin e legjislacionit për fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe të dhënat e tjera relevante për fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.
2. Regjistri i të dhënave për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë, në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 18
Shtojcat

1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë shtojcat, si në vijim:
 - 1.1. Shtojca Nr. 1 - Kërkesë për licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare;
 - 1.2. Shtojca Nr. 2 - Lista e ofrueseve të shërbimeve sociale dhe familjare për licencim.

Neni 19
Shfuqizimi

1. Me këtë Udhëzim Administrativ shfuqizohen aktet, si në vijim:
 - 1.1. Udhëzimi Administrativ MPMS nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Joqeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare;
 - 1.2. Udhëzimi Administrativ MPMS nr. 01/2020 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare të Nivelit Bazik, të Mesëm dhe të Lartë.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Andin HOTI

**Ministri i Ministrisë për Punë, Familje dhe
Vlerat e Luftës Çlirimtare**

08.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačke Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

KËRKESË PËR LICENCIM
TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Datë: ____/____/____

Emri i Subjektit Juridik/Organizatës _____

Adresa e Subjektit Juridik/Organizatës _____

Statusi i Subjektit Juridik/Organizatës

- Institucion publik ☐
- Organizatë Joqeveritare ☐
- Person fizik ☐
- Person Juridik ☐

Shërbimet për të cilat kërkohet licenca, emri i ofruesit të shërbimeve dhe lloji i shërbimeve:

I paraqes Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare këtë kërkesë për licencim të ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Kërkesës për licencim i bashkëngjes dokumentet në vijim (rretho dokumentacionin e dorëzuar):

1. Aktin e themelimit të institucionit publik;
2. Certifikatën e regjistrimit për organizatat joqeveritare, personat fizikë dhe juridikë;
3. Statutin me të cilin dëshmohet ushtrimi i aktivitetit në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, për të cilin aplikohet për licencim;
4. Planin e ofrimit të shërbimeve, shërbimet dhe numrin e përfitueseve;
5. Certifikatë pronësie, kontratë qiraje apo dokument tjetër të organit kompetent, si dëshmi për hapësirën e mjaftueshme;

6. Dëshmi që i plotëson kushtet e parapara në pikëpamje të hapësirës, infrastrukturës dhe kuadrit profesional;
7. Dëshmi për listën e pajisjeve adekuate që ka në pronësi ose në posedim për ofrimin e shërbimeve;
8. Kopjen e licencave të ofruesve individualë varësisht nga lloji i shërbimit që aplikon për licencim, së bashku me kontratën e punës apo dëshminë me të cilën konfirmon marrëveshjen për ofrimin e shërbimit;
9. Certifikatën nga Gjykata kompetente që subjekti juridik nuk është në proces të falimentimit;
10. Certifikatën për evidencën penale për personat përgjegjës të subjektit juridik;
11. Dëshminë lidhur me detyrimet tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (në teksti e mëtejme ATK).

Komente shtesë lidhur me aplikimin dhe dokumentacionin e dorëzuar apo që mungon:

Duke konfirmuar që të gjitha dokumentet dhe informatat janë të sakta dhe të lëshuara nga organet kompetente, pajtohem që mund të më kontaktoni për çdo informatë shtesë apo që sipas detyrës zyrtare të kontaktoni institucionet kompetente, lidhur me dokumentacionin e paraqitur në aplikimin tim.

- ☐ **Përfaqësuesi/t Juridik;**
- ☐ **Përfaqësuesi i Autorizuar**

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

Email: _____

Tel: _____

SHTOJCA NR. 2:



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare

Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačke Borbe

Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

**Lista e ofruesëve të shërbimeve sociale dhe familjare për
licencim**

Nr.	Ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare	Lloji i institucionit	Përfituesi/ja	Shërbimi
1.	Qendra për Punë Sociale	Institucion publik ☐	Përfitues i shërbimeve sociale dhe familjare - individi, - anëtarët e familjes, - familja në tërësi, të cilët realizojnë të drejtën për përfitimin e shërbimeve dhe mbrojtjen nga ky institucion.	- Vlerëson nevojat e përfituesve; - Identifikon, vlerëson dhe planifikon ofrimin e shërbimeve; - Ofron mendime dhe vlerësime profesionale; - Zbaton metodat e punës sociale. Menaxhimi i rastit, përmes metodave të tjera profesionale; - Referon dhe koordinon shërbimet me institucionet e tjera; - Përcjell dhe analizon problemet e përfituesve nga fusha e shërbimeve sociale; - Zbaton dhe mbikëqyr format e mbrojtjes sociale dhe juridike, si: - Kujdestaria, - Strehimi familjar, - Strehimi rezidencial, - Adoptimi dhe - Jetesa e pavarur e mbikëqyrur; - Kryen mbikëqyrjen ndaj familjeve strehuese dhe për përfituesit e shërbimeve në strehim familjar dhe në strehim rezidencial; - Siguron masa të mbrojtjes përmes formave alternative të përkujdesjes për fëmijën e ikur apo larguar nga prindërit apo institucioni; - Siguron dhe zbaton masat edukuese ndaj fëmijës me çrregullime në

				sjellje jashtë familjes së tij apo me qëndrim në familje; - Zbaton aktivitete në fushën e parandalimit të trafikimit me njerëz, të dhunës në familje, të dhunës së bashkëmoshatarëve dhe të problemit të varësisë.
2.	Këshillimorja familjare	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Individi, - Familja, - Grupi, - Profesionistët, - Institucionet.	- Shërbimet e këshillimit në parandalim; - Puna me individin, familjen, grupin përmes shërbimeve këshilluese-terapeutike; - Shërbime psiko-sociale për familjen; - Punë edukative me përfituesit e shërbimeve dhe të punësuarve në sistemin psiko-social; - Shërbimet e këshillimit të prindërimit të mirë; - Përkrahje profesionale institucioneve dhe organizatave në ngritjen e kapaciteteve të institucionit dhe profesionistëve për këshillim familjar; - Organizim i takimeve me grupet dhe komunitetin për promovimin e marrëdhënieve familjare të shëndetshme të jetës; - Punë analitike profesionale nga sfera e marrëdhënieve familjare.
3.	Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë pa përkujdesje prindërore apo pa përkujdesje familjare	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐	- Fëmijë pa përkujdesje prindërore apo	- Siguron strehim; - Ushqim dhe veshmbathje; - Këshillim social; - Këshillim psikologjik;

		Person fizik ☐ Person Juridik ☐	pa përkujdesje familjare.	- Aktivitete edukative; - Shërbime shëndetësore; - Terapi punuese; - Aktivitete rekreative dhe kulturore-zbavitëse; - Në pajtim me aftësitë e tyre, llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, ofron mbështetje në arsimim dhe aftësim; - Shërbimet e jetesës së pavarur të mbikëqyrur sipas planit individual; - Menaxhimi i jetës së përditshme; - Aktivitete për sigurim të punësimit dhe vetëpunësimit dhe të ardhura të qëndrueshme; - Shërbimet për vend të qëndrueshëm dhe të sigurt për të jetuar; dhe - Aftësimi profesional.
4.	Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare.	- Siguron strehim; - Ushqim dhe veshmbathje; - Këshillim social; - Këshillim psikologjik; - Aktivitete edukative; - Shërbime shëndetësore; - Aktivitete rekreative dhe kulturore-zbavitëse; - Terapi punuese; - Në pajtim me aftësitë e tyre, llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, ofron mbështetje në arsimim dhe aftësim; - Shërbimet e jetesës së pavarur të mbikëqyrur sipas planit individual; - Menaxhimi i jetës së përditshme;

				- Punësim dhe të ardhura të qëndrueshme; - Shërbimet për vend të qëndrueshëm dhe të sigurt për të jetuar; dhe - Aftësimi profesional.
5.	Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë me sjellje asociale	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Fëmijë me sjellje asociale.	- Siguron mbrojtjen; - Strehimin e fëmijës; - Ushqim dhe veshmbathje; - Shërbime higjienike dhe shëndetësore; - Mësimin e fëmijës në institucionin për ruajtje dhe edukim; - Këshillim social; - Këshillim psikologjik; - Shërbime edukative; - Aktivitete rekreative dhe kulturore-zbavitëse; - Terapi punuese dhe ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes jashtë familjes së tij dhe shërbimeve të arsimimit të fëmijëve dhe të personave të rinj me sjellje asociale.
6	6. Shtëpi me Bazë në Komunitet për persona të rritur dhe të moshuar 6.1. Institucion për persona të moshuar pa përkujdesje familjare	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Persona të moshuar pa përkujdesje familjare.	- Mbrojtje dhe strehim të të moshuarve; - Ushqim dhe veshmbathje; - Këshillim social; - Këshillim psikologjik; - Shërbime shëndetësore; - Shërbime rehabilituese; - Shërbime riintegruese; - Aktivitete tjera rekreative sociale; - Mirëmbajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve familjare për

				persona me paaftësi intelektuale dhe të moshuarit; - Shërbimet e jetesës së pavarur të mbikëqyrur sipas planit individual; - Menaxhimi i jetës së përditshme; - Përkrahje në punësim dhe të ardhura të qëndrueshme; - Shërbimet për vend të qëndrueshëm dhe të sigurt për të jetuar; - Aftësim profesional; - Riaftësimiprofesional.
7.	7. Shtëpia me Bazë në Komunitet për persona të rritur dhe të moshuar 7.1. Institucioni për persona me paaftësi intelektuale	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Persona me paaftësi intelektuale,	- Mbrojtje dhe strehimin e personit me paaftësi intelektuale; - Ushqim dhe veshmbathje; - Këshillim social; - Këshillim psikologjik; - Shërbime shëndetësore; - Shërbime rehabilituese; - Shërbime të ri integrit; - Terapi punuese; - Aktivitete tjera rekreative sociale; - Mirë mbajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve familjare persona me paaftësi intelektuale.
8.	8. Ofruesit e shërbimeve për mbështetje dhe përkujdesje në shtëpi 8.1. Ofruesit e shërbimeve për mbështetje dhe përkujdesje në shtëpi - Të moshuarit, personit të pafuqishëm dhe personit me aftësi të kufizuar	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Të moshuarit, - Personit të pafuqishëm, dhe - Personit me aftësi të kufizuar.	- Përkujdesje për nevojat individuale në kryerjen e punëve të domosdoshme shtëpiake; - Shërbime psiko – sociale; - Shërbime për mbështetje në funksionimin e pavarur; - Përkujdesje në shtëpinë e tyre për plotësimin e nevojave personale me ushqim, higjienë dhe nevoja të tjera shëndetësore;

				- Shërbime të socializimit dhe përfshirjes sociale; - Shërbimet e jetesës së pavarur të mbikëqyrur sipas planit individual; - Menaxhimi i jetës së përditshme; - Shërbimet për vend të qëndrueshëm dhe i sigurt për të jetuar; - Aftësim profesional; - Riaftësim profesional.
9.	9. Ofruesit e shërbimeve për mbështetje dhe përkujdesje në shtëpi 9.1. Ofrues i shërbimeve për mbështetje dhe përkujdesje në shtëpi për fëmijës me aftësi të kufizuara dhe fëmijë me sëmundje kronike të rënda	Institucion publik ☐ Organizate Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Fëmijë me aftësi të kufizuar dhe fëmijë me sëmundje kronike të rënda.	- Përkujdesje për përmbushjen e nevojave individuale; - Shërbime psiko – sociale; - Shërbime për mbështetje në funksionimin e pavarur; - Përkujdesje në shtëpinë e tyre për plotësimin e nevojave personale me ushqim, higjienë dhe nevoja të tjera shëndetësore; - Aktivitete rekreative dhe kulturore-zbavitëse; - Shërbime të socializimit dhe përfshirjes sociale.
10.	Strehimoret për fëmijën pa kujdes prindëror	Institucion publik ☐ Organizate Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Fëmijë viktimë të dhunës pa kujdes prindëror	- Sigurimi i strehimit; - Mbrojtje sociale; - Ushqim, veshmbathje dhe shërbime higjienike; - Këshillim social; - Këshillim psikologjik; - Aktivitete edukative jo formale; - Mbështetja në shkollimin formal; - Shërbime shëndetësore; - Terapi punuese; - Aktivitete rekreative dhe kulturore-zbavitëse;

				- Shërbime të specializuara varësisht nga lloji dhe nevojat e fëmijës.
11.	Strehimoret për viktimat e dhunës në familje	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.	- Strehim të sigurtë; - Shërbime për mbrojtjen; - Shërbime rehabilitimit dhe ofrimin e mbështetjes së specializuar; - Këshillimin psikologjik; - Shërbime psiko – sociale; - Shërbime shëndetësore; - Shërbime të këshillimit juridik; - Riintegrim, fuqizim për përfshirje sociale; - Riaftësim, aftësim profesional dhe punësim; - Avokim dhe ndërmjetësim për mundësi të punësimit.
12.	Strehimoret për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Fëmijë, - Të rrituri, - Të moshuar.	- Strehim të sigurtë; - Shërbime për mbrojtjen; - Ushqim, veshmbathje dhe shërbime higjienike; - Këshillim psikologjik; - Kujdes shëndetësor; - Shërbime të edukimit joformal; - Shërbime të shkollimit formal; - Rehabilitim dhe shërbime të specializuara; - Shërbime psiko – sociale; - Shërbime shëndetësore; - Shërbime juridike; - Riintegrimin, fuqizim për përfshirjen sociale;

				- Aktivitete për aftësim dhe riaftësim profesional; - Avokim dhe ndërmjetësim për mundësi të punësimit.
13.	Strehimore për viktimat e dhunës me bazë gjinore apo ndonjë formë tjetër të dhunës dhe mbrojtjes sociale	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Viktimë e dhunës me bazë gjinore apo ndonjë formë tjetër të dhunës dhe mbrojtjes sociale ,	- Strehim të sigurt; - Shërbime të mbrojtjes sociale; - Shërbime për rehabilitim dhe mbështetje të specializuar; - Shërbime psiko – sociale; - Këshillimin psikologjik; - Kujdes shëndetësor; - Këshillim juridik; - Riintegrimin, fuqizim për përfshirjen sociale; - Aftësim dhe riaftësim profesional; - Avokim dhe ndërmjetësim për mundësi të punësimit.
14.	Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës	Institucion publik ☐	- Fëmijët viktimë të dhunës me theks të veçantë veprave penale të integritetit seksual, kur edhe është viktimë apo dëshmitar.	- Shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, jo më gjatë se tre (3) ditë; - Shërbime për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet e dhunës, me theks të veçantë veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmija është viktimë apo dëshmitar; - Shërbime këshilluese, veçanërisht terapi të ndryshme; - Shërbime të strehimit të përkohshëm të fëmijës, i cili nuk ka mundësi të kthehet në shtëpi, nuk mund të strehohet në strehim familjar, apo është në shtëpi por kërkohet largimi i tij për shkak të

				rezikut që i kanoset jetës apo shëndetit të tij.
15.	Qendra e Kujdesit Ditor për fëmijë	Institucion publik ☐ Organizate Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	Fëmijë	- Shërbime të kujdesit ditor; - Shërbime të rehabilitimit; - Shërbime të specializuara, terapeutike, logopedike, ergoterapi, fiziatrike, por pa u kufizuar në to; - Shërbime psiko-sociale; - Këshillim psikologjik; - Kujdes shëndetësor; - Këshillim juridik; - Riintegrim, fuqizim për përfshirje sociale.
16.	Qendra e Kujdesit Ditor për të rritur dhe të moshuar	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Personat e rritur dhe të moshuar në nevojë	- Shërbime të këshillimit, - Aktivitete rekreative/sportive dhe socializuese, - Këshillim psikologjik,
17.	Qendra për Shërbime Sociale të Specializuara.	Institucion publik ☐ Organizatë Joqeveritare ☐ Person fizik ☐ Person Juridik ☐	- Fëmijë, - Të rriturit, - Të moshuarit.	- Shërbime sociale dhe mbështetëse; - Këshillim individual për vetëkujdes; - Këshillim psikologjik për fëmijët dhe të rinjtë, të rriturit dhe të moshuarit; - Shërbime të trajtimit dhe rehabilitimit, sipas vlerësimit dhe nevojave individuale; - Mbështetje emocionale dhe psikologjike; - Ndihmë në përditshmëri (ushqyerje, higjienë dhe veshje); - Shërbime shëndetësore; - Terapi fizike dhe rehabilitim nga varësitë;

				- Kujdes, përkrahje psiko- sociale për personat të cilët janë përdorues të substancave psiko-aktive, të lojërave të fatit, abuzimit me alkool; - Shërbime të përkrahjes psiko-sociale për fëmijët pa kujdes prindëror të vendosur në strehim familjar, brenda familjes biologjike dhe në familje strehuese; - Shërbime të përkrahjes psiko-sociale për prindërit strehues; - Aktivitete për prindërim të mirë për prindërit strehues; - Përkrahje në edukim dhe arsimim formal për fëmijët pa kujdes prindëror; - Përkrahje në edukim jo formal; - Përkrahje përmes aktiviteteve socializuese; - Kultivimi i raporteve familjare dhe mirëmbajtja e tyre me familjen biologjike; - Shërbime të aftësimit dhe riaftësimit profesional; - Shërbime të riintegritit dhe fuqizimit në jetën sociale; - Shërbime përkrahëse për jetesë të pavarur të mbikëqyrur; - Aftësim për jetesë dhe punë të pavarur; - Shërbime për ngritjen e kapaciteteve të prindërve strehues për përkujdesje adekuate;
--	--	--	--	---

				- Shërbime psiko-sociale për të rinjtë, të rriturit dhe të moshuarit në strehim familjar; - Shërbime të riintegritit dhe fuqizimit në jetën sociale për të rinjtë, të rriturit dhe të moshuarit në strehim familjar; - Shërbime të këshillimit social e psikologjik përmes linjës telefonike për viktimat e dhunës në familje; - Referim në shërbime ekzistuese.
18.	Qendra për Pranim	Institucion publik ☐	- Fëmijët e braktisur, - Fëmijët me çrregullime në sjellje, - Personat e rritur me sjellje shoqërore negative, - Shtatzënat dhe nënat me fëmijë të vegjël deri në një vit të jetës së fëmijës, - Personave për shkak të pasigurisë materiale, të çështjes banesore të pazgjidhur, të	- Strehim të sigurtë; - Shërbime për mbrojtjen sociale; - Ushqim, veshmbathje dhe shërbime higjienike; - Këshillim psikologjik; - Kujdes shëndetësor; - Shërbime të edukimit joformal; - Shërbime të shkollimit formal; - Rehabilitim dhe shërbime të specializuara; - Shërbime psiko–sociale; - Shërbime shëndetësore; - Shërbime juridike; - Riintegrimin.

			marrëdhëniet e familjare të çrregulluara, dhe të situatave të ngjashme, - Personat që kanë nevojë për kujdes të përkohshëm, - Personat e tjerë të cilët kanë nevojë për përkujdesje sociale urgjente.	
--	--	--	---	--

